



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI KOMBËTAR I BANESAVE

Nr. 554/₅ prot, datë 10/06 / 2024

(Selia: Rruga e Kavajës, ndërtesa Nr.80, hyrja 1, kati 5 (ish shtëpia botuese "Naim Frashëri" Tiranë)

BASHKIA KORÇË

Nr. 3125/₅ prot, datë 03/06 / 2024

(Selia:)

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

MBI ZBATIMIN E PROGRAMIT PËR NDËRTIMIN E BANESAVE ME KOSTO TË ULËT NË BASHKINË KORÇË

Mbështetur në Ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Ligjin nr.22/2018 "Për Strehimin Social" i ndryshuar, si dhe në përputhje me Vendimin Nr.198 datë 4.05.1993 të Këshillit të Ministrave "Për krijimin e Entit Kombëtar të Banesave" i ndryshuar:

Lidhet kjo marrëveshje bashkëpunimi, ndërmjet palëve:

- Enti Kombëtar i Banesave, përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm, Z. Stefan Çipa;
- dhe
- Bashkia e qytetit Korçë, përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë, Z.Sotiraq Filo.

Neni 1

Qëllimi i marrëveshjes

1. Qëllimi i marrëveshjes është të përcaktojë angazhimin e ndërsjelltë të Entit Kombëtar të Banesave dhe të Bashkisë Korçë, për një bashkëpunim dypalësh në funksion të përcaktimit të fushave, masave dhe mënyrave të bashkëpunimit, si dhe të sigurimit të mbështetjes së nevojshme institucionale nëpërmjet zbatimit të legjislacionit të fuqi me pikësynimin: